

## **KUSHTET E GARANCIONIT PËR POMPË AJRI (NR. ART: 0997715038)**

Për të gjitha pompat e ajrit japim garancion me kushtet si vijon:

### **GARANCIONI:**

1. Garancioni vlen 6 (gjashtë) muaj nga data e blerjes së pompës së ajrit e cekur në fletëgarancion, e cila vie së bashku me faturën e blerjes.
2. Garancioni vlen vetëm nëse pompa e ajrit i është dorëzuar agjentit të shitjes së Wurth, shitores ku është blerë apo servisit të autorizuar për evitimin e prishjes - defektit.
3. Garancioni mbulon të gjitha të metat në pompën e ajrit që janë si pasojë e materialit nga i cili është prodhuar por edhe si pasojë e gabimeve gjatë procesit të prodhimit.

Në rast të përmbushjes së kushteve të cekura më lart, për kohëzgjatjen sa vlen garancioni, Wurth-Kosova Shpk do të mbulojë shpenzimet e riparimit të pajisjes-veglës.

Nëse pajisja-vegla i dorëzohet përfaqësuesit të Wurth-Kosova, atëherë mbulohen shpenzimet e transportit.

Wurth-Kosova Shpk obligohet që pajisjen ta riparojë në afat të caktuar ose të ofrojë ndërrimin me të re.

### **GARANCIONI NUK VLEN NË KËTO RASTE:**

1. Nëse blerësi nuk dorëzon së bashku me pompën e ajrit edhe faturën origjinale të blerjes si dhe fletëgarancionin.
2. Nëse blerësi nuk i është përmbajtur udhëzimeve për mirëmbajtje dhe përdorim të drejtë të pajisjes-veglës.
3. Nëse pajisja-vegla gjatë kohës nën garancion, është hapur nga servisi i paautorizuar, apo nga ndonjë person i tretë, atëherë garancioni anulohet automatikisht, ndërsa shpenzimet e riparimit dhe transportit i bartë vetë blerësi.
4. Nëse gjatë kohës së garancionit, prishjet janë shkaktuar si pasojë e konsumimit (shpenzimit të pjesëve), përdorimit jo të drejtë të pajisjes-veglës, modifikimit apo përdorimit të aksesorëve jo-origjinal, atëherë të gjitha shpenzimet i bartë blerësi.
5. Nëse prishja në pajisje-vegël ka ndodhur si pasojë e dhunës së tepruar (katastrofave të natyrës, keqpërdorimit etj.)

Wurth-Kosova Shpk obligohet të sigurojë pjesë rezervë dhe funksionim të servisit në afat prej 5 (pesë) vite prej datës së blerjes së pajisjes-veglës e cila është cekur në fletëgarancion.

Pajisjet-veglat të cilat nuk kanë garancion, por që riparohen në servisën e autorizuar të Wurth-Kosova Shpk, ne ju japim garancion të ri prej 6 (gjashtë) muaj për pjesët e ndërruara dhe kualitetin e shërbimit.

Kryerja e shërbimeve për të cilat ka skaduar garancioni, nuk nënkupton vazhdim apo zgjatje të garancionit.

Përveç të drejtave për riparim të defekteve në pajisje-vegla, të definuara me këtë fletëgarancion, nga i njëjti nuk derivojnë të drejta tjera

Falemnderit për mirëkuptim!